



RAPORTIMI I KORRUPSIONIT NË MEDIAN AUDIO-VIZIVE DHE TË SHKRUAR: RASTI I SHQIPËRISË

**RAPORTIMI I KORRUPSIONIT
NË MEDIAN AUDIO-VIZIVE
DHE TË SHKRUAR:
RASTI I SHQIPËRISË**

Dhjetor, 2014

Publikuar nga: Balkan Investigative Reporting Network, Albania
Blv. Gjergj Fishta, No. 5/22
Tirana, Albania

Raporti nga: Alba Cela
Gjergj Erebara

Antarë të ekipit: Oerd Bej
Suzana Selmani

Redaktor: Besar Likmeta

Përgjegjës: Kristina Voko

© Balkan Investigative Reporting Network, Albania
Tirana, 2014

Ky botim u mundësua me mbështetjen e Fondacionit të Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë, Soros. Përmbytja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Balkan Investigative Reporting Network, Albania (BIRN Albania) dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Soros.

Përmbajtja

1. Hyrje	4.
1.1 Korrupsioni në Shqipëri	4
1.2 Roli i medias në luftën kundër korrupsionit	6
1.3 Qëllimi i raportit	8
1.4 Përkufizime	9
2. Metodologjia	13
2.1 Mediat e përzgjedhura	13
2.2 Periudha e monitorimit	14
2.3 Instrumentët monitorues	14
3. Gjetjet kryesore	17
4. Gjetjet e detajuara	20
4.1 Shpeshhtësia dhe tipologjia e raportimit	20
4.1.1 Mbulimi	20
4.1.2 Fushat	22
4.1.3 Gjatësia	24
4.1.4 Rëndësia	24
4.1.5 Ilustrimet	26
4.1.6 Zhanri	27
4.2 Cilësia dhe besueshmëria e raportimit	29
4.2.1 Autorësia	29
4.2.2 Numri i burimeve	30
4.2.3 Origjina e burimit	32
4.2.4 Palët e prekura	33
4.2.5 Arsyeja e lajmit	35
5. Diskutime dhe përfundime	38
5.1 Çështje për diskutim	38
5.2 Konkluzione	42

1

Hyrje

1.1 Korrupsioni në Shqipëri

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit nënvizon faktin se pavarësisht se korrupsioni është një fenomen global, ai dëmton më tepër vendet e varfra dhe ato në zhvillim, duke devijuar asetet e kufizuara nga objektivi për t'i ofruar qytetarëve mundësi më të mira jete drejt abuzimit.¹ Shqipëria ka nënshkruar Konventën në vitin 2003 dhe e ka ratifikuar atë 3 vite më pas, megjithatë realiteti pasqyrohet ndryshe, me korrupsion endemik të pranishëm nga nivelet më të larta të pushtetit deri tek zyrtarët publikë të nivelit të ulët, gjë që ul mundësinë e vendosjes së sundimit të ligjit si parim udhëzues të qeverisjes dhe përmirësimit të shërbimeve publike.

Nga pikëpamja institucionale dhe juridike, gjatë dekadës së fundit Shqipëria ka bërë progres drejt vendosjes dhe zhvillimit të kapaciteteve shtetërore në luftën kundër korrupsionit. Procesi i integritit europian ka shërbyer si një nxitje e fuqishme duke e mbajtur luftën kundër korrupsionit në vëmendjen e politikanëve dhe të medias duke e kthyer korrupsionin në një element kushtëzues prioritar për hapat e mëtejshëm drejt anëtarësimit në BE.

Sipas Raportit të fundit të Vlerësimit të Korrupsion në Shqipëri², 66% e të anketuarve identifikuan korrupsionin si një nga tre problemet më kryesore

1. United Nations Convention against Corruption, <https://www.unodc.org/unodc/en/treaties/CAC/>

2. Albanian Corruption Assessment Report', Albanian Center For Economic Research (ACER), Tirana: 2014, pg 6.

të vendit. Shtetasit shqiptarë janë në të njëjtën kohë më të ndjeshëm ndaj cënueshmërisë së korrupsionit dhe përfshirjes në praktika korruptive në raport me shtetasit e Europës Juglindore. Më shumë se 45 përqind e shqiptarëve, gjatë vitit të kaluar, raportuan se u është ofruar ryshfet, dhe 39 përqind e tyre raportuan se kanë paguar ryshfet; pra janë përfshirë në një praktikë korruptive.

Gjithashtu, të dhënat sugjerojnë që rezistenca ndaj korrupsionit në Shqipëri është shumë e ulët. Shqiptarët janë më pak të bindur, krahasuar me fqinjët e tyre në rajon, se masat dhe praktikant antikorrupsion do të kenë një ndikim të matshëm në luftën kundër fenomenit, dhe 73 për qind e tyre nuk besojnë se politikant antikorrupsion mund të jenë të suksesshme.³

Në “Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit”, botuar nga Transparency International në 2014, Shqipëria dhe Kosova renditen si vendet më të korruptuara në Ballkanin Perëndimor, duke treguar nivele vazhdimisht të larta të korrupsionit të perceptuar.⁴ Si pasojë e numrit të vogël të rasteve të korrupsionit të individëve të profilit të lartë që kanë rezultuar në dënime, në vend mbizotëron një ndjesi e përgjithshme pandëshkueshmërie dhe besimi publik në institucionet e ngarkuara për të luftuar këtë praktikë është cënuar ndjeshëm. Sipas raporteve të Progresit të njëpasnjëshme të Komisionit Europian mbi Shqipërinë, vendi s’ka krijuar ende raste të përndjekjes së korrupsionit në nivelet e larta.⁵ Institucionet më pak të besuara nga qytetarët shqiptarë, pothuajse çdo vit, kanë qenë gjykatat dhe partitë politike.⁶

3. “Anticorruption reloaded; Assessment of Southeast Europe”, Red: O.Shentov, R.Stefanov, B. Todorov, SELDI (Southeast Europe Leadership for Development and Integrity) Sofia: 2014, fq 149-150.

4. <http://www.transparency.org/cpi2014/results>

5. <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52012DC0472>

6. “The state of Albanian democracy at the eve of the 2013 General Elections”, Albanian Institute for International Studies (AIIS), Tirana: 2013, pg 38. Same results are confirmed in 2014 poll by Institute for Democracy and Mediation (IDM): OPINION POLL “TRUST IN GOVERNMENT” within the framework of OPEN GOVERNMENT PARTNERSHIP PROJECT, http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2014/12/Factsheet_trustingov2014.pdf

1.2 Roli i medias në luftën kundër korrupsionit

Në shumë vende që kanë kaluar nga sundimi totalitar në demokraci, media ka luajtur një rol të rëndësishëm në përkrahjen e demokracisë duke ndërtuar një kulturë të sinqeritetit dhe të ekspozimit, e cila i bën qeveritë e zgjedhura në mënyrë demokratike përgjegjëse, përfshin qytetarët në qeverisje duke i informuar dhe edukuar, si dhe mobilizon publikun.⁷ Roli i medias në raport me korrupsionin dhe përpjekjet antikorrupsion është i shumëfishtë, dhe mund të përdoret si një armë kundër korrupsionit, duke sjellë rezultate të drejtpëdrejta dhe jo të drejtpëdrejta. Rezultatet e drejtpëdrejta shpesh lidhen me raportimin investigativ që kontribuon në fillimin e një investigimi kriminal kundër një zyrtari publik, dorëheqjen e politikanëve të korruptuar apo dhënien fund të ligjeve apo politikave që nxisin praktikat korruptive.⁸ Rezultatet jo të drejtpëdrejta lidhen me rolin e mbikëqyrësit në raportimin e rasteve korruptive të cilat rrisin ndjenjën e përgjegjësisë tek zyrtarët e votuar, institucionet apo organet publike. Media, dhe veçanërisht gazetaria investigative, është parë si një trajtim për “sëmundjen” e korrupsionit.⁹

Në këtë kontekst, media mund të përmbushë rolet e mëposhtme:

1. Ekspozon dhe raporton faktet në lidhje me rastet korruptive dhe individët e përfshirë
2. Ushtron presion të vazhdueshëm për të garantuar llogaridhënien dhe ndjekjen e rastit, duke luftuar kështu pandëshkueshmërinë
3. Ekspozon mangësitë ligjore dhe rrugëdaljet, si dhe ndihmon në adresimin

7. “The Role of Media in Deepening Democracy” Sheila S. Coronel. <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/un/unpan010194.pdf>

8. “Media’s Role in Curbing Corruption” Rick Stapenhurst. <http://siteresources.worldbank.org/INTWBIGOVANTCOR/Resources/media.pdf>

9. ‘Words to action- Investigative journalism to corruption’ Free Media Movement, pg 6

e këtyre çështjeve

4. Konfirmon, cilëson, madje edhe kundërshton perceptimet popullore mbi korrupsionin
5. Ushtron vigjilencë në lidhje me vetë këtë sektor duke luftuar korrupsionin nga brenda.¹⁰

Për shkak të natyrës dominuese të korrupsionit në Shqipëri, media është përqendruar gjithmonë në rastet dhe çështjet korruptive, si dhe në reformat e ndryshme për të luftuar korrupsionin. Megjithatë, prania e lajmeve mediatike dhe përqëndrimi i tyre tek tematika e korrupsionit nuk përbën në vetvete garanci që do të jetë një mjet efektiv kundër këtij fenomeni. Ashtu si çdo institucion tjetër, media gjithashtu mund të jetë e korruptuar dhe në shumë raste nuk i përmbahet idealeve të saj, duke u shndërruar në një aktor indirekt në betejën mes grupeve rivale politike.

Në mënyrë që media të luajë një rol në luftën kundër korrupsionit, është i nevojshëm një mjedis i përshtatshëm dhe aftësi profesionale të mundësojnë prodhimin e raportimeve investigative dhe të thelluara që kanë rezultate të drejtpërdrejta ose indirekte kundër praktikave korruptive. Raportimi investigativ dhe i thelluar kërkon një sërë burimesh, punë në terren, verifikim faktesh, përqendrim të e mira publike përkundrejt jetës private, si dhe që gazetarët të shkojnë përtej asaj që ata kanë parë ose kanë dëgjuar me qëllim zbulimin e padrejtësive.

Jo çdo raportim mbi korrupsionin është raport investigativ. Në pjesën më të madhe është një mbulim i lajmeve të përditshme ku gazetarët duhet të marrin informacionin, të vlerësojnë rëndësinë e tij, të verifikojnë saktësinë e fakteve, të balancojnë dhe ta vendosin në kontekst, me qëllim prodhimin e

10. Roles are summarized from Trevor Munroe: "The role of the media in combating corruption and strengthening governance", 18/7/2011 http://www.cba.org.uk/wp-content/uploads/2012/03/110718_Roleofmedia.pdf

një kronike koherente lajmesh.¹¹ Megjithatë, që media të jetë një mjet efektiv kundër korrupsionit, raportimi investigativ, ashtu si dhe mbulimi i përditshëm i rasteve korruptive, duhet t'i përmbahet parimeve udhëzuese dhe standardeve të gazetarisë. Këto parime mund të ndryshojnë midis organizatave mediatike, por gjithmonë përfshijnë standarde si: saktësia, objektiviteti, plotësia, ndershmëria dhe paanshmëria.

1.3 Qëllimi i raportit

Për të vlerësuar natyrën dhe tipologjinë e raportimit të mediave shqiptare mbi korrupsionin, si dhe përputhjen e tyre me parimeve bazë të gazetarisë, të cilat mundësojnë mediat të jenë një mjet efektiv kundër korrupsionit, BIRN Albania ka kryer një studim monitorues të medias audio-vizive dhe asaj të shkruar në Shqipëri për një periudhë tre mujore.

Qëllimi i këtij studimi është të prezantojë dhe interpretojë një përmbledhje të karakteristikave të përgjithshme, si dhe cilësinë dhe besueshmërinë e raportimit të mediave shqiptare mbi çështjet dhe rastet korruptive bazuar në disa tregues sasiore, me qëllim identifikimin e problemeve të mundshme dhe mangësive në implementimin e standardeve të gazetarisë.

Gjetjet e këtij monitorimi kanë për qëllim:

- Të përdoren si material referencë për të ndihmuar aktorët lokalë dhe ndërkombëtarë të përfshirë në zhvillimin e medias në Shqipëri, sindikatat e gazetarëve, si dhe gazetarët dhe redaktorët, për të ndërmarrë projekte dhe veprime që do të rrisin cilësinë dhe sasinë e raportimeve mbi korrupsionin, pandëshkueshmërinë dhe efikasitetin e politikave antikorrupsion;

11. Digging Deeper: A Guide to Investigative Journalism in the Balkans. Sheils S. Coronel, page 13. BIRN, 2009

- Të nxisin aktorë të ndryshëm të bëjnë ndërhyrje që kanë për qëllim përmirësimin e raportimit në përgjithësi (jo vetëm mbi tematikën e korrupsionit), si dhe të monitorojnë cilësinë dhe karakteristikat e raportimit të mediave në Shqipëri në vazhdimësi;
- Të ndihmojnë gazetarët shqiptarë të adresojnë pikat e tyre të dobëta, si dhe të përdoren si manual ndërgjegjësimi për përmirësimin e raportimeve të rasteve të korrupsionit. Shpresohet që raporti monitorues të ndihmojë organizatat që kanë më shumë epërsi strukturore të merren me këto çështje me qëllim informimin e publikut me profesionalizëm, paanësi dhe me detaje; dhe
- Të forcojnë rolin e medias në luftën kundër korrupsionit dhe të adresojnë problemet e ndërlidhura që mund të kenë ndikim pozitiv në luftën kundër korrupsionit në përgjithësi, si dhe të rikthejnë besimin e publikut në mediat dhe institucione të tjera.

1.4 Përkufizime

Të gjesh përkufizimin e saktë dhe të përshtatshëm të “korrupsionit” si një tematikë që duhet monitoruar është një sfidë, sepse ai duhet të jetë mjaftueshëm gjithëpërfshirës për të mbuluar disa elementë dhe çështje, si dhe t’i përgjigjet natyrës komplekse të fenomenit të ndërlidhur me probleme politike, ekonomike dhe juridike. **Përkufizimi** që do të përdoret në këtë studim është i njëjti me atë të përdorur nga *Transparency International*¹²:

“Korrupsioni është abuzimi i pushtetit për përfitime personale. Ai dëmton këdo që varet nga integriteti i individëve në pozitë vendimarrëse.”

12. http://www.transparency.org/whatwedo?gclid=CP_vspSDysACFazItAodYlka2g

Ky përkufizim shkon përtej kornizimit të korrupsionit vetëm si abuzim me postin zyrtar apo çështje të kodit penal dhe i adresohet natyrës së tij si një fenomen sistematik. Njëkohësisht, përkufizimi përfshin elementin e “përfitimit personal” i cili shpesh nuk ka natyrë financiare apo materiale. Ai përfshin kuptimin tradicional dhe me gjerë, të korrupsionit politik: “si zyrtarë që tregtojnë favore për kontribute të fushatave elektorale apo mbështetje (apo përfitime të tjera); si dhe zyrtarë që shkëmbejnë favore për përfitime monetare ose dhurata, apo “korrupsion të paligjshëm”.¹³

Korrupsioni në këtë kontekst përfshin, por nuk kufizohet në rastet e mëposhtme:

- Ryshfete;
- Përvetësim, vjedhje dhe mashtrim;
- Zhvatje;
- Abuzim me pushtetin;
- Favorizimin, nepotizmin, klientelizmin;
- Kontribute politike të papërshtatshme.¹⁴

Një tjetër çështje e integruar në fenomenin e korrupsionit, e cila raportohet së bashku me të, është “pandëshkueshmëria”, e cila është kthyer në një term të nxehtë në diskutimet politike në Shqipëri, dhe në të njëjtën kohë shfaqet në raportet ndërkombëtare të vlerësimit për vendin. Shqipëria karakterizohet nga një kulturë mbizotëruese e pandëshkueshmërisë, “... *kultura e pandëshkueshmërisë* është qasja ose sjellja e një grupi shoqëror që vetëkonsiderohet i përjashtuar nga ndëshkimi. E thënë ndryshe, mënyra se si njerëzit sillen kur mendojnë se mund të mos ndëshkohen dhe mos mbahen

13. “A state guide to political corruption, according to the reporters who cover it”, 8/12/2014 NirajChokshi, Washington Post:<http://www.washingtonpost.com/blogs/govbeat/wp/2014/12/08/a-state-guide-to-political-corruption-according-to-the-reporters-who-cover-it/>

14. ‘Words to action- Investigative journalism to corruption’ Report, Free Media Movement, pg 6.

përgjegjës për veprimet e tyre”.¹⁵ Në të vërtetë, Transparency International Albania thekson se dy problemet më karakteristike (të korrupsionit në Shqipëri janë: a) mosndëshkimi i zyrtarëve të lartë nga ligjit dhe institucionet gjyqësore, dhe b) mungesa e zbatimit të ligjit dhe e luftimit të kulturës së pandëshkueshmërisë.¹⁶

Për të vlerësuar respektimin e parimeve udhëzuese të gazetarisë nga mediat shqiptare gjatë raportimit mbi korrupsionin, BIRN Albania ka përdorur përkufizimet e mëposhtme¹⁷:

Saktësia: Qëllimi i raportimit të medias është të ndjekë të vërtetën. Verifikimi i kujdesshëm është shumë i rëndësishëm. Organet e medias duhet të kujdesen që deklaratat apo faktet të jenë korrekte dhe brenda kontekstit. Raportimi, në mënyrë rigorozë, duhet të sfidojë pretendimet e hasura dhe supozimet që ai sjell. Mediat duhet të përdorin burimet dhe aftësitë e nevojshme për të paraqitur versionin me të plotë të së vërtetës, duke i kushtuar rëndësi informacionit që ka mbledhur dhe verifikuar.

Objektiviteti: Për të treguar ngjarjen në mënyrë sa më të vërtetë, është e rëndësishme që mediat të trajtojnë ata që intervistojnë dhe raportojnë me drejtësi skrupuloze, të udhëhequr nga parimi i profesionalizmit. Mediat duhet të bëjnë të pamundurën të marrin përgjigje nga ata që janë subjekt i kritikës, akuzave të pafavorshme apo pohimeve të tjera negative mbi historinë e tyre.

Plotësia: Mediat duhet të bëjnë të pamundurën të raportojnë ngjarjet në mënyrë sa më të plotë dhe gjithëpërfshirëse. Gabimet e mospërfshirjes dhe gjysëm të vërtetat mund t'i shkaktojnë dëme të mëdha besueshmërisë, dhe ngjarjet e raportuara pa kontekstin e duhur nuk janë të plota. Gazetaria

15. Solita Collas-Monsod, Business World 9/05/2012, <http://www.econ.upd.edu.ph/perse/?p=1054>

16. 'TIA presents the results of the CORRUPTION PERCEPTIONS INDEX(CPI) 2013', 12/02/2014 <http://www.tia.al/en/?p=38>

17. 'Ethics Handbook', US's National Public Radio, <http://ethics.npr.org/category/a-preamble/>

duhet të përfshijë zëra të ndryshëm që reflektojnë shoqërinë në përgjithësi dhe pikpamje të kundërta që kontribuojnë në një debat të informuar.

Ndershmëria: Gazetarët duhet të sillen me ndershmëri me qëllim që të fitojnë besim. Gjatë punës së tyre, gazetarët duhet të tregojnë vërtetësi dhe sinqeritet. Ata duhet të raportojnë duke i bërë publikut/lexuesit sa më të qartë informacionet dhe burimet e tyre. Gazetarët duhet të shmangin hiperbolat dhe hamendësimet e bujshme. Vetëm në raste të rralla – si përshebull kur bëhet fjalë për sigurinë publike, ose jetë njerëzish – ata mund të fshehin identitetin ose qëllimin e raportimit.

Paanshmëria: Gazetarët kanë opinione si të gjithë njerëzit. Megjithatë publiku meriton raportime të bazuara në fakte dhe analiza të informuara, të pandikuara nga opinionet e vetë gazetarëve. Ata duhet të përpiqen të raportojnë dhe prodhojnë ngjarje që i tejkalojnë paragjykimet dhe i trajtojnë të gjitha pikëpamjet në mënyrë të barabartë. Gazetarët duhet që të sfidojnë pikëpamjet e tyre personale dhe të ndjekin një gamë pikpamjesh të ndryshme, me qëllimin e vetëm që e vërteta të pasqyrohet në versionin më të plotë të saj.

2

Metodologjia

Ky studim monitorimi u krye duke identifikuar dhe mbledhur treguesit sasiorë në artikujt e publikuar nga gazetatat e përditshme dhe në kronikat e edicioneve qendrore të lajmeve mbi rastet apo çështjet e lidhura me korrupsionin.

2.1 Mediat e përzgjedhura

Mediat u identifikuan bazuar në mbulimin kombëtar dhe gamën e qasjeve editoriale, dhe secila prej tyre u monitorua për një periudhë tre mujore. Mediat e përzgjedhura, artikujt dhe kronikat televizive të të cilave u monitoruan dhe u përdorën për mbledhjen e të dhënave, janë:

- Televizioni Shqiptar – Televizioni publik shqiptar i cili mbulon jo vetëm territorin e Republikës së Shqipërisë por ka një audiencë në territoret e populluara me shqiptarë në vendet fqinj. TVSH-ja transmetohet gjithashtu nëpërmjet satelitit (edicioni qendror është në orën 20.00)
- Top Channel – Televizion kombëtar, pjesë e paketës satelitore, me audiencë në të gjithë diasporën shqiptare (edicioni qendror është në orën 19.30)
- TV Klan – Televizion kombëtar, pjesë e paketës satelitore, me audiencë në mbarë diasporën shqiptare (edicioni qendror është në orën 19.30)
- Panorama – Gazetë e përditshme
- Gazeta shqip – Gazetë e përditshme
- DITA – Gazetë e përditshme

Përzgjedhja e mediave të mësipërme u bë në mënyrë që të arrihet një përfaqësim i shumëllojshmërisë së mediave në vend, gjë që do të lehtësojë përgjithësimin e gjetjeve për të gjitha mediat në Shqipëri, dhe jo vetëm të atyre të përzgjedhura. Për rrjedhojë, përdorimi i shembujve specifikë nga mediat e përzgjedhura në këtë raport bëhet vetëm për arsye ilustruese, dhe jo për të shenjësuar një media të veçantë.

2.2 Periudha e monitorimit

Periudha e monitorimit për mbledhjen e të dhënave të raportit ishte 20 Gusht – 20 Nëntor. Përgjatë kësaj periudhe, të gjitha gazetat dhe edicionet qendrore të lajmeve të televizioneve të përzgjedhur janë monitoruar përditë për të identifikuar të gjithë artikujt dhe kronikat e lajmeve të cilët mbulonin raste apo çështje të lidhura me korrupsionin.

2.3 Instrumentët monitorues¹⁸

Të gjithë artikujt dhe kronikat televizive të identifikuara nëpërmjet monitorimit të 6 mediave të përzgjedhura janë analizuar duke përdorur një sërë treguesish, vlerësimi i të cilëve është bërë duke përdorur një instrument specifik të hartuar nga grupi i ekspertëve. Pas përfundimit të periudhës së monitorimit, të gjitha të dhënat e mbledhura u regjistruan në një matricë të veçantë, ku dhe u përpunuan.

Me qëllim vlerësimin e natyrës dhe tipologjisë së raportimit të korrupsionit nga mediat shqiptare, si dhe respektimin e parimeve të gazetarisë nga ana

18. Shënim: Instrumentet e përdorur për mbledhjen e të dhënave për këtë raport janë bazuar pjesërisht në ato të 'Rezultatet e Monitorimit të raportimit të mediave lidhur me interes shoqëror, të definuara bashkërisht nga ana e gazetarëve dhe përfaqësuesve të organizatave civile në Maqedoni', prodhuar nga Qendra e Komunikimeve Qytetare në Shkup për Balkan Investigative Reporting Network, Macedonia në 2013.

tyre, ky studim monitorimi u bazua në një sërë treguesish. Këta treguesë janë ndarë në dy grupe; grupi i parë mat shpeshtësinë dhe tipologjinë e raportimit të korrupsionit në mediat shqiptare, ndërsa grupi i dytë i treguesve vlerëson cilësinë dhe besueshmërinë e raportimit në vetvete.

Treguesit e shpeshtësisë dhe tipologjisë përfshijnë:

Mbulimi: Shpeshtësia e raportimit të rasteve apo çështjeve të korrupsionit nga mediat e përzgjedhura audio-vizive dhe të shkruar gjatë peridhës së monitorimit.

Fushat: Shpeshtësia e raportimit të korrupsionit nga mediat e përzgjedhura audio-vizive dhe të shkruar në sektorë të ndryshëm si pushteti gjyqësor, administrate publike, etj.,

Gjatësia: Gjatësia e një artikulli në një faqe gazete ose kohëzgjatja e një kronike televizive gjatë edicionit të lajmeve.

Rëndësia: Rëndësia që i është dhënë artikujve mbi korrupsionin, duke i vendosur ato në faqe të parë apo në faqet e brendshme të gazetave, si dhe transmetimi i kronikave mbi korrupsionin në pjesën e parë të edicionit të lajmeve ose prezantimi i tyre në përmdhledhjen e lajmeve.

Ilustrimi: Ilustrimi ose jo i lajmit me foto origjinale në gazeta apo me filmime origjinale në kronikat televizive.

Zhanri: Shpeshtësia e përdorimit të zhanreve të ndryshme të gazetarisë në raportimin e rasteve apo çështjeve të korrupsionit, si intervistat, reportazhet, investigimet, etj.

Treguesit e cilësisë dhe besueshmërisë përfshijnë:

Autorësia: Nëse një artikull i shkruar apo një kronikë e transmetuar është nënshkruar nga autori.

Burimet: Numri i burimeve, opinioneve, informacionit apo të dhënave të cilat janë përdorur në një artikull apo kronikë të caktuar, dhe nëse raportimi

përfshin burime të identifikuara, burime anonime apo një kombinim të të dy llojeve

Palët e përfshira: Një raport është i plotë nëse të gjitha palët e prekura, pohimet dhe opinionet mbi çështjen ose fushën janë të përfshira, dhe nëse palëve të akuzuara u është dhënë e drejta për t'iu përgjigjur akuzave.

Origjina e lajmit: Nëse një artikull apo kronike e caktuar është reaguese ose proaktive, bazuar në informacionin e dhënë nga të tjerë, ose të ekspozuar nga reporterët dhe nëse bazohet në një ngjarje të vërtetë apo jo.

3

Gjetjet kryesore

- Korrupsioni raportohet shpesh në mediat shqiptare. Gazetat mbulojnë çështje të lidhura me korrupsionin çdo ditë. Në tre gazetat e përditshme të përzgjedhura janë identifikuar 715 artikuj mbi korrupsionin gjatë periudhës 92 ditore të përfshirë në këtë raport. Gjithashtu janë identifikuar 290 kronika mbi korrupsionin në tre televizionet e monitoruara.
- Çështjet e korrupsionit të raportuara më shpesh në gazeta i përkasin fushës së administratës publike (43% e artikujve), politikës (20% e artikujve) dhe qeverisjes lokale (11% e artikujve). Në edicionet e lajmeve, fushat më të raportuara që kanë lidhje me korrupsionin janë politika (52% të kronikave) dhe administrata publike (29% të kronikave).
- Çështjet e korrupsionit më pak të raportuara janë në fushat e krimit të organizuar dhe shërbimit shëndetësor, përkatësisht me 11 dhe 18 artikuj nga 715 në total. Për sa i përket televizionit, fushat e korrupsionit më pak të mbuluara janë: shërbimi shëndetësor me 3 kronika dhe krimi i organizuar me vetëm 1 kronikë nga 290 gjithsej. Gjatë periudhës së monitorimit nuk ka pasur asnjë kronike televizive mbi korrupsionin në fushën e arsimit.
- Shumica e artikujve të gazetave, rreth 80%, janë të gjatë jo më shumë se çerek apo gjysëm faqe. Gjysma e kronikave televizive kanë një kohëzgjatje prej 1-2 minutash, ndërsa pjesa tjetër është kryesisht më e shkurtër. Gjatësia e shkurtër e artikujve dhe e kronikave televizive sugjeron se shumica e raportimeve mbi korrupsionin gjatë periudhës së monitorimit kanë qenë sipërfaqësore.

- Rëndësia e lajmeve mund të matet duke studiuar vendndodhjen e lajmit në një gazetë ose në një edicion lajmesh. Në gazetatat e monitoruara, artikujt mbi korrupsionin, në shumicën e rasteve (82%) janë vendosur në faqen e brendshme të gazetave dhe jo në faqe të parë. Për sa i përket kronikave televizive, situata është e ndryshme; gjysma e lajmeve mbi korrupsionin prezantohen gjatë paraqitjes së titujve kryesorë të edicionit.
- Shumica e artikujve të gazetave të përditshme (61%) përmbajnë fotografi ilustrative, 21% kanë fotografi origjinale, dhe vetëm 1% e artikujve përmbajnë tabela dhe/ose grafikë. 17% e artikujve nuk përmbajnë asnjë fotografi apo figurë. Edhe në rastin e televizioneve, 46% e kronikave shoqërohen me pamje nga arkivi. Prezenca e vogël e pamjeve dhe fotografive origjinale në televizion dhe gazeta sugjeron se shumica e ngjarjeve bazohen në pseudo-ngjarje si njoftimet për shtyp.
- Lajmi është zhanri më i praktikuar në Shqipëri ndërsa zhanret e tjera shfaqen jashtëzakonisht pak si në median e shkruar ashtu edhe në televizionet e monitoruara në rastet e mbulimit të temës së korrupsionit. Gjatë periudhës së monitorimit, në 715 artikuj mbi korrupsionin, u identifikuan vetëm 36 intervista/komente dhe 16 raporte investigative në median e shkruar. Në edicionet e lajmeve, nga 290 kronika u identifikuan vetëm 17 intervista/komente dhe 6 raporte investigative.
- Identifikimi i autorësisë nëpërmjet publikimit apo transmetimit të emrit të plotë të gazetarit është i ulët. Vetëm 40% e artikujve në gazeta dhe 32% e kronikave në televizione përmbajnë emrin e plotë të gazetarit.
- Shumica e artikujve në gazetë (51%) bazohen vetëm në një burim dhe një numër i konsiderueshëm (9%) nuk kanë asnjë burim. Shumica dërrmuese e lajmeve në televizion (82%) ka vetëm një burim. Pavarësisht se shumica e artikujve në gazeta dhe kronikave në lajme kanë burime të identifikuar, 54 artikuj dhe 14 kronika kishin burime anonime.

- Burimet e mediave shqiptare janë zakonisht nga sektori publik dhe partitë politike. Rreth 71% e artikujve në gazetë i kanë burimet nga sektori publik, dhe 25% e tyre nga partitë politike. Në rastin e kronikave televizive, 56% e tyre kanë si burim partitë politike dhe 43% kanë sektorin publik. Vetëm 1% e burimeve në median e shkruar dhe atë auto-vizive vjen nga sektori privat.
- Në shumicën e rasteve, si në raportimin e mediave të shkruara ashtu edhe në atë audio-vizive, pala e prekur nga çështja nuk është konsultuar (504 artikuj dhe 212 kronika). Në rastet kur konsultimi ka ndodhur, shkalla e reagimit ka qenë mjaft pozitive dhe vetëm një pakicë e vogël ka refuzuar të lëshojë një deklaratë pas konsultimit.
- Media shqiptare raporton kryesisht mbi pseudo-ngjarje, ku 90% e artikujve dhe kronikave televizive e kanë origjinën nga konferencat e ndryshme për shtyp dhe nga deklaratat e partive. Vetëm 6% e artikujve dhe 4% e kronikave kanë qenë rezultat i një ngjarjeje të vërtetë, dhe një përqindje akoma më e vogël kanë qenë produkt i një investigimi.
- Këto ngjarje të raportuara nga artikujt dhe kronikat mbi korrupsionin organizohen në shumicën e rasteve nga sektori publik apo partitë politike. Në rastin e artikujve në gazetë, ngjarjet e organizuara nga këto dy sektorë përfaqësojnë më shumë se 88% të të gjitha rasteve. Në kronikat televizive, të njëjtën organizatorë janë përgjegjës për më shumë se 78% të ngjarjeve të raportuara.

4

Gjetjet e detajuara

4.1 Shpeshtësia dhe tipologjia e raportimit


Treguesit e tipologjisë janë një instrument i rëndësishëm i matjes së nivelit të mbulimit të çështjeve dhe rasteve të korrupsionit sepse tregojnë jo vetëm hapësirën që i është dedikuar fenomenit në shtypin lokal dhe median audio-vizive, por edhe pasqyrojnë karakteristikat e përgjithshme të këtij mbulimi. Kjo pjesë e raportit do të përfshijë setin e të dhënave për 6 treguesit sasior që përfshijnë shpeshtësinë e mbulimit të çështjeve korruptive në median e shkruar dhe audio-vizive, gjatësia e artikujve dhe kronikave, rëndësinë që i kushtohet artikujve dhe kronikave në gazetë dhe në edicionin e lajmeve, ilustrimet, si dhe zhanrin e përdorur nga gazetarët dhe redaktorët për të mbuluar ngjarjet që kanë lidhje me korrupsionin në median e shkruar dhe atë audio-vizive.

4.1.1 Mbulimi

Shpeshtësia e mbulimit të çështjeve të përzgjedhura dhe rasteve përkatëse mund të përcaktohet nga faktorë të jashtëm dhe të politikës editoriale. Kur lajmi i prodhuar është kryesisht reagues (mbulim i ngjarjeve të organizuar nga parti politike apo institucione), shpeshtësia e raporteve tregon se fenomeni është shumë i përhapur në shoqëri. Kur raportimet janë njëkohësisht reaguese dhe sipërmarrëse, tregon jo vetëm se fenomeni është i përhapur por edhe që organizatat e medias alokojnë burime me qëllim ekspozimin e çështjes apo rasteve përkatëse në sferën publike. Gjatë periudhës së monitorimit shpeshtësia e raportimit të rasteve apo çështjeve të korrupsionit në median e shkruar apo audio-vizive është e madhe. Gjatë kësaj periudhe, u identifikuan

290 kronika televizive dhe 715 artikuj në gazeta që kishin lidhje me çështjen apo raste të korrupsionit në tre kronika televizive dhe tre gazeta të cilat ishin objekt i këtij studimi.

Mbulimi i rasteve të korrupsionit



Për sa i përket medias audio-vizive, numrin më të vogël të kronikave mbi korrupsion e mban televizioni publik (TVSH) me 73 raporte, ndërsa dy televizionet e tjera (Top Channel dhe Klan TV) së bashku regjistruan 217 raporte mbi korrupsionin, ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë midis tyre.

Shpeshtësia e raportimit të korrupsionit në tre gazetatat e monitoruara nuk kishte luhatje të mprehta. E përditshmja Panorama publikoi 264 artikuj që kishin lidhje me çështje apo raste korrupsioni, e përditshmja Shqip 228 dhe e përditshmja Dita 223.


Gjatë periudhës së monitorimit të tre gazetatat publikuan dy herë më shumë artikuj mbi raste apo çështje korruptive krahasuar me tre mediat audio-vizive, TVSH, TV KLAN dhe Top Channel. Duke pasur parasysh se numri i ditëve të monitoruara është 92, mesatarja ditore e artikujve në fushën e korrupsionit në të tre mediat e shkruara është 7.7.

Sa i përket mbulimit në edicionet qendrore në tre kanalet televizive, mesatarja e kronikave që kishin lidhje me korrupsionin është 3 në ditë.

4.1.2 Fushat Një nga qëllimet e monitorimit të mediave të përzgjedhura është të identifikojë artikujt/kronikat mbi korrupsionin dhe t'i kategorizojë ato në bazë të disa fushave të paracaktuara. Për këtë raport artikujt/kronikat u grupuan në fushat: arsim, shëndetësi, mjedis, drejtësi, pushtet vendor, administratë publike, krim i organizuar, politikë dhe të tjera.


Shumica e artikujve të monitoruar në median e shkruar i përkasin këtyre katër fushave: administratë publike, politikë, pushtet vendor dhe drejtësi. Gjatë periudhës së monitorimit 304 artikuj mbi korrupsionin, apo 43% të artikujve të botuar nga të tre gazetave të monitoruara, i përkasin fushës së administratës publike. Kategoria e dytë më e raportuar në lidhje me çështjet apo rastet e korrupsionit është politika me 141 artikuj (20% e artikujve), ndjekur nga pushteti vendor me 78 artikuj (11% e artikujve), dhe sistemi gjyqësor me 64 artikuj (9% e artikujve) në mediat e shkruara të përzgjedhura. Fushat në të cilat korrupsioni është raportuar më pak janë shëndetësia, mjedisi, arsimit dhe krimi i organizuar. Gjatë periudhës së monitorimit, 28 ngjarje korrupsioni i përkasin fushës së mjedisit, 26 arsimit, 18 shëndetësisë dhe 11 krimin të organizuar. Këto tema përbëjnë 13% të mbulimit total të rasteve apo çështjeve të korrupsionit në mediat e shkruara të përzgjedhura për monitorim.

Fushat e artikujve të gazetave




Fushat më të raportuara në çështjet që kanë lidhje me korrupsionin në tre televizionet e përzgjedhura gjatë periudhës së monitorimit janë politika dhe administrata publike, përkatësisht me 152 kronika nga 290 në total. Politika zë rreth 52% të mbulimit të përgjithshëm, dhe kronikat e korrupsionit mbi administratën publike përbëjnë 29% të totalit. Fusha e tretë me e raportuar në kronikat mbi korrupsionin është drejtësia me 20 kronika apo 7% të mbulimit total, ndjekur nga mjedisi me 15 kronika ose 5%. 18 kronika televizive ose 6% të numrit total i përkasin fushave të pushtetit vendor, shëndetësisë, arsimit dhe krimit të organizuar.

Fushat e kronikave televizive



Edhe pse fushat kryesore të rasteve të korrupsionit të raportuara në mediat e shkruara dhe audio-vizive janë administrata publike, politika, pushteti vendor dhe drejtësia, përqindjet e mbulimit që televizionet dhe gazetat i kushtojnë një fushe të caktuar janë të ndryshme. Ndryshimet kryesore në fushat e mbuluara i përkasin korrupsionit dhe administratës publike. Rastet korruptive në politikë kanë qenë fokusi i 52% të mbulimit total në median audio-vizive dhe 20% të artikujve në gazeta. Çështjet korruptive në administratës publike janë raportuar më shpesh në gazeta se sa në televizione, më konkretisht në 43% e artikujve kundrejt 29% të kronikave televizive.

Fushat e mbuluara në rastet e korrupsionit



4.1.3 Gjatësia

Gjatësia e një artikulli është një tregues i rëndësishëm sasior, i cili vlerëson thellësinë e raportimit të rastit apo çështjes së korrupsionit.

Shumica (80%) e artikujve në median e shkruar kanë një gjatësi prej gjysëm faqe ose më pak. 310 artikuj janë pothuajse çerek faqe të gjatë dhe kanë formën e një kutie apo kollone në cep të faqes, kurse 286 kanë një gjatësi rreth gjysëm faqe. 88 artikuj zënë një faqe të plotë gazete, dhe 40 artikuj janë më të thelluar duke zënë pothuajse dy faqe. Gjatë kohës së monitorimit, vetëm 10 artikuj kanë zënë një hapësirë të konsiderueshme, duke kaluar dhe dy faqe në gazetë. Këto artikuj përbëjnë vetëm 1% të artikujve të monitoruar.

Në tre televizionet e monitoruara, ka pothuajse një ndarje të barabartë midis kronikave televizive të thjeshta, zakonisht nën një minute, dhe raportimeve që mbulojnë një çështje në një kohëzgjatje 1-2 min. Këto shifra përkatësisht janë 127 dhe 149. Më pak se 4% e kronikave kanë një kohëzgjatje prej më shumë se 2 minutash në edicionet e lajmeve të monitoruara.


4.1.4 Rëndësia

Rëndësia që i është kushtuar një artikulli në gazetë apo renditja e kronikës në edicionin e lajmeve bazohet në rëndësinë e perceptuar nga ekipi redaktues.


Në praktikë, gazetat publikojnë ngjarjet kryesore në faqe të parë, ndërsa televizionet në pjesën e parë të lajmeve.

Në gazetat e monitoruara, artikujt në lidhje me korrupsionin, në shumicën e rasteve (82% apo 584 artikuj nga totali) janë vendosur në faqet e brendshme të gazetave. 56 artikuj të publikuar konsiderohen kryeartikuj (titull i madh në faqe të parë), 34 artikuj kanë një rëndësi dytësore (zakonisht kanë një titull të madh nën titullin kryesor të gazetës, dhe 41 prej tyre zënë vendin e tretë për nga rëndësia, duke u vendosur në një pozicion të dukshëm në kolonën e faqes së parë, ose duke u ilustruar me një foto në faqe të parë.

Rëndësia që i është dhënë artikujve mbi korrupsionin



Kronika të njoftuara si lajme kryesore



Gjatë edicioneve të lajmeve në televizionet e monitoruara, gjysmat e lajmeve mbi korrupsionin, 145 kronika, janë përmendur gjatë leximit të titujve kryesorë, gjë që i jep lajmit një rëndësi më të madhe duke tërhequr vëmendjen e audiencës.


4.1.5 Ilustrimet

Gjatë edicioneve qendrore të lajmeve, 41 kronika mbi korrupsionin kanë qenë lajm i parë. Këto kronika i përkasin më së shumti rastit të profilit të lartë të skandalit të Bankës Qendrore të Shqipërisë. Nga kronikat e mbetura, 180 janë transmetuar gjatë gjysmës së parë të edicionit të lajmeve (pjesa që shihet më shumë nga teleshikuesit) dhe 69 janë transmetuar gjatë gjysmës së dytë.

Ilustrimi i një artikulli gazete në median e shkruar me fotografi apo grafikë është zakonisht një tregues se raportimi i rastit të korrupsionit zë një vend të rëndësishëm në faqen e gazetës. Duke qenë se televizioni është një media audio-vizive, ilustrimi është pothuajse gjithmonë i pranishëm dhe nuk përbën një tregues po aq të rëndësishëm sa në median e shkruar. Megjithatë, edhe në televizion, në disa raste kronikat shoqërohen me material arkivi ose pamje ilustruese në vend të pamjeve origjinale.

Shumica e artikujve të përditshëm, 433 nga 715 në total (61%) shoqërohen me foto ilustruese, 151 (21%) kanë foto origjinale, dhe 7 (1%) artikuj përmbajnë tabela/grafikë. 124 nga 715 artikujt, ose 17% e tyre, nuk kanë asnjë fotografi apo figurë shoqëruese.


Ilustrimet e artikujve të gazetave mbi korrupsionin



Informacion shtesë për rëndësinë që i është dhënë artikullit të gazetës jepet dhe nga emërtimi i rubrikës të cilës artikulli i përket. Shumica e artikujve, mbi korrupsionin, rreth 384, i përkasin rubrikës “Aktualitete”. Rubrika e dytë me e shpeshtë është “Lajmet politike” me 208 artikuj, ndjekur nga “Rajoni” (lajme lokale) me 59 artikuj dhe “Ekonomi” me 26 artikuj. “Sociale” me 24 artikuj dhe “Investigime” me 3 artikuj.

Nga natyra e kronikave televizive, shumica e lajmeve shoqërohen me filmime. Në 153 raste (53%) kronikat kanë filmime origjinale të ngjarjes, ndërsa 135 prej tyre (46%) shoqërohen me filmime ose me material arkivi. Vetëm në dy raste (1%) lajmi nuk ka pasur kronike por janë lexuar nga folësi i lajmeve.

Lloji i filmimeve në kronikat televizive mbi korrupsionin




4.1.6 Zhanri Zhanri i gazetarisë i përzgjedhur nga gazetari për të raportuar një ngjarje, dhe më specifikisht çështje të korrupsionit, mund të jetë një tregues i mënyrës se si rasti është raportuar. Disa zhanre si lajmet televizive janë më të drejtpërdrejta, duke paraqitur vetëm faktet bazë të ngjarjes. Disa zhanre të tjerë si koment/analizë, intervistat, reportazhet apo raportet investigative janë tregues të një qasje me të thellë nga ana e gazetarit.

Në tre nga gazetatat e monitoruara, ngjarjet e thjeshta janë zhanri më i përdorur nga gazetarët. Nga 715 artikuj mbi korrupsionin gjatë periudhës së monitorimit, 664 (93%) prej tyre i përkasin zhanrit të lajmit. Pjesa tjetër, rreth 7% ndahet në


mënyrë të barabartë midis intervistave, komente/analiza, dhe investigimeve, përkatësisht 18 intervista, 18 komente/analiza dhe 15 investigime.

Zhanri i artikujve të gazetave mbi korrupsionin



Zhanri i lajmit dominonte në gazetarinë televizive në raportimin e çështjeve të korrupsionit gjatë periudhës së monitorimit. Nga 290 raporte mbi korrupsionin të transmetuara në tre televizionet e monitoruara, 267 (92%) prej tyre ishin kronika lajmesh. Pjesa tjetër (8%) përfshin 14 komente/analiza, 6 investigime dhe 3 intervista.

Zhanri i artikujve të televizioneve mbi korrupsionin




4.2 Cilësia dhe besueshmëria e raportimit

Grupi i dytë i treguesve të përdorur nga ky studim janë përfshirë për të matur cilësinë dhe përgjegjshmërinë e artikujve dhe kronikave të publikuara nga media shqiptare mbi çështjet dhe rastet e korrupsionit. Treguesit e përzgjedhur për të identifikuar cilësinë dhe besueshmërinë e artikujve/kronikave janë: autorësia, numri i burimeve, origjina e burimeve, konsultimi me palët e prekura, dhe origjina e lajmit.

4.2.1 Autorësia Autorësia tregon nëse një lajm i publikuar në gazetë është nënshkruar nga autori, ose në rastin e kronikave televizive, nëse gazetari që ka raportuar ngjarjen identifikohet në titullin e kronikës.


Gjatë periudhës së monitorimit, vetëm gjysma e artikujve në median e shkruar përmbajnë emrin e autorit. Një total prej 288 artikujsh kanë emrin e plotë të gazetarit, ndërsa 45 artikuj kanë vetëm inicialet. 20 artikuj janë riprodhime nga media të tjera, ndërkohë që 10 prej tyre kanë një shënim që tregon departamentin e lajmit (psh: *re.pol* do të thotë Redaksia e Politikës në gazeta). Nëngrupi më i madh prej 352 artikujsh nuk ka asnjë emër apo shënim që tregon autorësinë.

Autorësia e artikujve të gazetave



Nga monitorimet e edicioneve të lajmeve rezulton se 196 e kronikave mbi korrupsionin nuk kanë emrin e gazetarit kundrejt 93 kronikave që e kanë. Vetëm një kronikë ishte marrë nga një media tjetër.

Autorësia në kronikat tekevizive




4.2.2 Numri i burimeve

Burimet në media zakonisht i referohen një personi, publikimi, regjistrave apo dokumenteve që japin informacione në kohë. Artikujt dhe kronikat zakonisht duhet të kenë dy ose më shumë burime, me qëllim që raportimi të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe i plotë, duke paraqitur pikëpamje konkurruese dhe duke i dhënë palës së akuzuar të drejtën për t'u përgjigjur. Burimet ndahen në tre kategori kryesore: burime njerëzore, burime të dokumentuara, dhe burime elektronike, si psh regjistra.

Gjatë periudhës së monitorimit, 367 ose 51% e artikujve të publikuar në median e shkruar mbi çështjet e korrupsionit, ose që kanë lidhje me korrupsionin, kanë vetëm një burim. 156 artikuj kanë dy burime, ndërsa 125 artikuj kanë 3 ose më shumë burime në raportimin e tyre. Në 67 raste, apo 9% të artikujve të monitoruar, burimi nuk ishte identifikuar.


Numri i burimeve në artikujt e gazetave



Nga 648 artikuj me të paktën një burim, 543 kanë burime të cilët janë identifikuar me emër, dhe 54 janë burime anonime. Në 51 raste, kemi të bëjmë me një kombinim midis burimeve të identifikuar dhe të paidentifikuar.

Në edicionet e lajmeve të monitoruara, 239 (82%) nga 290 kronika mbi korrupsionin kanë një burim. 37 raste kronikat kanë dy burime, dhe në 6 raste kanë më shumë se dy burime. Vetëm 8 kronika nuk kanë një burim informacioni të identifikuar.

Numri i burimeve për kronikat televizive



Nga 282 kronika televizive me të paktën një burim, 257 pretj tyre kanë burim të identifikuar me emër, dhe 14 kanë burim anonym. Në 11 raste kemi të bëjmë me një kombinim midis burimeve të identifikuar dhe të paidentifikuar.


4.2.3 Origjina e burimit

Origjina e burimit të cituar në artikujt e gazetave apo kronikat televizive mbi korrupsionin është gjithashtu një tregues i rëndësishëm i cilësisë së raportimit të medias. Megjithëse institucione si policia ose zyra e prokurorit, të cilët shpesh janë konsideruar burime autoritative dhe hasen rëndom të cituara në ngjarjet e korrupsionit, raportimi cilësor ka nevojë për një shumëllojshmëri burimesh që e kanë origjinën nga institucione të ndryshme, qeveritare ose jo.

Për këtë studim burimet u grupuan në disa kategori përfshirë burimet nga sektori publik, sektori privat, sektori i shoqërisë civile, partitë politike dhe të tjera. Burimet nga sektori publik përfshijnë institucionet qeveritare si policia, zyra e prokurorit, agjenci të ndryshme dhe institucione të pavarura. Sektori privat përfshin kompanitë ose individët që nuk kanë lidhje me shtetin. Sektori i shoqërisë civile përfshin organizata jo-fitimprurëse dhe institucione akademike.

Gjatë periudhës së monitorimit, nga 648 artikuj të shtypit të përditshëm me të paktën një burim, 433 prej tyre (67%) kishin si origjinë burimi sektorin publik. Grupi i dytë i burimeve mbi të cilat mbështeten artikujt mbi korrupsionin përfshin partitë politike, me 163 (25%) artikuj nga 648 në total. 40 (6%) artikuj bazohen në informacion që vjen nga sektori privat. Vetëm 12 raste të mbulimit të korrupsionit në median e shkruar i bazonin artikujt në burime nga sektori i


Origjina e burimeve në artikujt e gazetave



shoqërisë civile, 7 prej të cilëve qenë nga organizatat jo-fitimprurës (1%) dhe 5 nga bota akademike (1%).

Nga 282 kronika mbi korrupsioni në tre televizionet e monitoruara me të paktën një burim, në shumicën e rasteve, 159 prej tyre ose 56% kishin si burim informacioni partitë politike. Grupi i dytë më i madh i artikujve kanë si burim informacioni sektorin privat, me 121 (43%) artikuj në total. Ndërkohë burimet që vijnë nga shoqëria civile apo sektori provat përbëjnë më pak se 1% të 282 artikujve.

Origjina e burimeve në kronikat televizive




4.2.4 Palët e prekura

Një nga parimet bazë të gazetarisë është përfshirja e të gjitha palëve në lajm. Që një ngjarje të quhet e plotë dhe gjithëpërfshirëse, të gjitha palët dhe burimet duhet të jenë të përfshira në kontekstin e duhur. Jo të gjitha palët që kanë lidhje me ngjarjet korruptive janë objekt i akuzave. Sipas standardeve të gazetarisë, individit, instucionit apo kompanisë që është objekt i akuzës duhet t'i jepet e drejta t'i përgjigjen akuzave me qëllim paraqitjen e mbrojtjes përkatëse.

Konsultimi me palën e prekur në një rast apo çështje të caktuar nuk ishte marrë në konsideratë nga shumica e artikujve mbi korrupsionin, me një


total prej rreth 505 artikujsh ku palës së akuzuar nuk i është dhënë e drejta t'i përgjigjej akuzave. Në 193 raste pala e akuzuar është kontaktuar dhe ka lëshuar një deklaratë, dhe në një numër të kufizuar rastesh, vetëm 17, pala është kontaktuar, por ka refuzuar të lëshojë deklaratë apo të komentojë mbi akuzat.

Konsultimi i palëve të prekura në artikull



Për sa i përket kronikave televizive, në shumicë e raportimeve mbi korrupsionin në televizionet shqiptare palës së akuzuar nuk i është dhënë e drejta e pozicionimit. Në 212 nga 290 raportime, pala e akuzuar nuk ishte konsultuar, dhe vetëm në 64 raste, pala kishte lëshuar një deklaratë pasi i ishte dhënë e drejta për t'iu përgjigjur akuzave. Në 14 raste, pala ishte kontaktuar por kishte refuzuar të komentonte.

Konsultimi i palës së prekur në kronikat televizive




4.2.5 Arsyeya e lajmit

Mungesa e raportimit origjinal vihet më shumë në dukje kur merret në konsideratë arsyeya e përgatitjes së artikullit apo kronikës televizive. Arsyeya e përgatitjes së artikullit/kronikës u përcaktua duke grupuar ngjarjen prej së cilës artikulli/kronika kishte origjinën në ngjarje autentike dhe pseudo-ngjarje. Një pseudo-ngjarje është përkufizuar si një ngjarje, qëllimi vetëm i secilës është të tërheqë vëmendje mediatike dhe që organizohet nga një institucion apo një grup interesi.

Gjatë periudhës së monitorimit, vetëm 44 (6%) e artikujve në median e shkruar bazoheshin në ngjarje autentike, ndërsa shumica dërrmuese e artikujve (640 ose 90% e numrit total) janë përgatitur si produkt i mbulimit të një pseudo-ngjarjeje (konferenca shtypi, deklarata partie, njoftime për shtyp, etj.). Një numër tepër i vogël, 15 (2%) artikuj janë produkt i një procesi të hollësishëm investigimi dhe për rrjedhojë kanë origjinë nismën e vetë gazetarit. 16 (2%) artikuj mbi korrupsionin, gjatë periudhës së monitorimit, nuk bazohen as në ngjarje autentike apo pseudo-ngjarje, por në burime të tjera si raportet apo deklaratat ndërkombëtare etj.


Arsyeya e përgatitjes së lajmit



Rezultatet konfirmohen akoma më shumë kur merren në konsideratë aktorët që qëndrojnë pas ngjarjes së raportuar. Prandaj sektori publik është organizatori kryesor i ngjarjeve që përbëjnë 540 artikuj, ndjekur nga ngjarjet


e partive politike që përbëjnë 92 artikuj dhe ngjarjet e sektori privat me 40 artikuj. Artikujt që janë produkt i ngjarjeve apo kontributeve të shoqërisë civile (sektori jo fitimprurës) apo ekspertë/akademikë të pavarur përbëjnë vetëm 7 artikuj përkatësisht, që përbën një minorancë të padukshme.

Organizatorët e ngjarjes së raportuar në artikujt e gazetave




Raporte të ngjashme vihen re dhe në monitorimin e kronikave televizive të televizioneve të monitoruara. Vetëm 12 raste raportonin bazuar ne ngjarje autentike krahasuar me 261 kronikat e bazuara në pseudo-ngjarje. Në edicionet e lajmeve janë identifikuar vetëm 10 kronika investigative mbi korrupsionin në periudhën tre mujore të monitorimit.

Arsyeja e përgatitjes së lajmit



Aktorët kryesorë që qëndrojnë si organizatorë të ngjarjeve që raportohen në kronikat televizive janë partitë politike me 124 kronika. Sektori publik përbën 104 kronika. Ka një numër të konsiderueshëm kronikash, 58 në total, që nuk mund t'i përkasin një aktori specifik. Vetëm në 4 raste organizatorët e ngjarjeve ishin nga sektori privat, shoqëria civile ose ekspertët.

Organizatorët e ngjarjes në lajmet e raportuara në televizione



5

Diskutime dhe përfundime

5.1 Çështje për diskutim

Gjetjet e këtij raporti monitorimi mbi mbulimin e korrupsionit nga media në tre gazetat e përditshme dhe edicionet e lajmeve të tre televizioneve kombëtare sugjeron se raportimi i rateve të korrupsionit në Shqipëri është i bollshëm. Numri i lartë i artikujve apo kronikave televizive mbi këtë çështje konfirmon faktin që korrupsioni është një fenomen i përhapur në Shqipëri, dhe si i tillë, është një nga pikat kryesore të diskursit publik në vend.

Megjithatë, pavarësisht mbulimit të gjerë të rasteve apo çështjeve të korrupsionit, të dhënat sasiore të analizuara dhe përmbajtja e lajmeve të monitoruara sugjerojnë që në median shqiptare mbizotërojnë lajme apo ngjarje të prodhuara nga partitë politike dhe institucionet kryesore publike. Kjo sjell për pasojë që:

- Artikujt dhe kronikat televizive mbi korrupsionin bazohen kryesisht në pseudo-ngjarje të krijuara nga njoftimet për shtyp të partive politike apo nga konferencat për shtyp të institucioneve publike (si ministritë, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, Policia e Shtetit, etj), të cilët janë identifikuar si organizatorët kryesorë të ngjarjeve të raportuara në media mbi rastet e korrupsionit;
- Duke u mbështetur kaq shumë në qeverinë apo administratën publike të cilat përdoren si burime të informacionit, mund të argumentohet se media nuk e luan dot rolin e mbikëqyrës. Për më tepër, në rastet ekstreme,

mbështetja ekskluzive tek partitë politike apo aktorë të tjerë mund të shtrembrojë rolin e medias në një shoqëri demokratike duke e kthyer atë në një instrument propagande;

- Lajmet e raportuara mbi korrupsionin, të cilat kanë si burime aktorët e sipërpërmendur bazohen kryesisht në një burim të vetëm, që nga një anë rrit artificialisht numrin e lajmeve mbi korrupsionin, dhe nga ana tjetër lë pak ose aspak hapësirë për analizimin e lajmeve dhe debatin kritik në lidhje me çështjet e raportuara. Për shembull, shpesh raportimet mbi ngjarjet e ndërlidhura paraqiten nëpërmjet deklaratave ose shkëmbimit të akuzave midis partive ose aktorëve politikë; ose midis qeverisë dhe bashkisë së Tiranës (të kontrolluar nga opozita). Shpesh këto lajme raportohen veçmas me pak ose aspak të dhëna të pavarura ose kontekst nga burime të tjera.
- Përqëndrimi në lajmet e ngjarjeve të organizuara ose që e kanë burimin nga partitë politike dhe institucionet kryesore publike lë shumë pak vend për raportime nga sektorë të tjerë të shoqërisë ose qeverisë që ndikohen nga korrupsioni, si psh mjedisi, shëndetësia, ose arsimi, të cilat shpesh janë të nënraportuara. Ky përqëndrim kufizon edhe mbulimin e rasteve apo çështjeve korruptive jashtë kryeqytetit, duke e bërë që pjesa tjetër e vendit të mos mbulohet nga raportimet.
- Burimet kryesore të përfaqësuara në median e shkruar apo atë audio-vizive janë nga këto dy sektorë (partitë politike dhe institucionet publike), duke i lënë pak hapësirë opinionëve të aktorëve të tjerë, si psh përfaqësues të organizatave jo-fitimprurëse, aktivistëve ose akademikëve, si dhe publikut në përgjithësi. Siç argumentohet dhe në literaturë, “Përkushtimi ndaj qytetarëve do të thotë se gazetaria ka për detyrë të paraqesë një imazh gjithëpërfshirës të të gjithë grupeve përbërëse të shoqërisë. Mospërfillja e një grupimi të caktuar rrezikon t’i “alienizojë” ata.”¹⁹

19. Principles of Journalism Pew Research Center, <http://www.journalism.org/resources/principles-of-journalism/>

Lajmet televizive janë më të politizuara se gazetat, në tematikën e mbuluar dhe në përdorimin e partive politike si burime lajmesh ose organizatorë të ngjarjeve të raportuara. Kjo mund të jetë si rezultat i konkurrencës midis gazetave dhe televizioneve: gazetat shpesh nuk mund të bazohen vetëm në konferenca/deklarata për shtyp nga partitë politike apo institucionet qeveritare për të shitur produktin e tyre duke qenë se këto deklarata mbipërdoren nga televizionet dhe portalet e lajmeve në internet shumë më herët se gazeta të dalë në treg. Gjithashtu, nga informacioni i mbledhur nga ky studim monitorues, rastet e akuzave zyrtare ose publike të korrupsionit ose abuzimit të pushtetit nga zyrtarë të lartë dhe politikanë mbulohen gjerësisht nga media shqiptare, duke rezultuar shpesh në tabloidizimin e tyre dhe duke ulur numrin e raportimeve të rasteve të korrupsionit të zyrtarëve të niveleve të ulta. Një shembull i kësaj njëanshmërie mund të ilustrohet me krahasimin e rastit të Vjedhjes së Thesarit në Bankën Qendrore dhe akuzat për shpërdorim detyre kundër ish guvernatorit Ardian Fullani, dhe rastet e akuzave për mitmarrje dhe shpërdorim detyre të disa kryekomunarëve, të raportuara gjatë periudhës së monitorimit. Edhe pse rasti i Bankës Qendrore u raportua nga 75 kronika dhe 105 artikuj gazetash, në më shumë se 30% të lajmeve vëmendja nuk është te vjedhja në vetvete, por në jetën personale të guvernatorit dhe familjes së tij. Nga ana tjetër, edhe pse gjatë periudhës së monitorimit kishte 8 raste të kryekomunarëve të akuzuar për korrupsion apo shpërdorim detyre, këto ngjarje u pasqyruan vetëm në 9 kronika televizive dhe 36 artikuj gazetash. Pothuajse i gjithë informacioni i ofruar nga këto kronika dhe artikuj ishte një ribotim i thjeshtë i deklaratave për shtyp të policisë apo i prokurorisë mbi arrestimet. Vëmendja e medias zbehet dhe nuk ka ndjekje të mëtejshme të rasteve, gjë që dëmton aftësinë e saj për të luajtur rolin e mbikqyrësit të abuzimeve apo pandëshkueshmërisë së mundshme të këtyre rasteve.

Përveç prirjes së lartpërmendur për të mbuluar rastet e profilit të lartë, të dhënat e mbledhura gjatë periudhës së monitorimit tregojnë gjithashtu një

tendencë të fortë për tabloidizimin e rasteve të korrupsionit, të cilat shpesh zhvendosin vëmendjen e publikut larg çështjeve të abuzimit të pushtetit ose pandëshkueshmërisë. Ekziston një nxitje e fuqishme nga mediat për të ndjekur përmbajtjen që bashkon rastet e korrupsionit me përmbajtje thashethemi apo skandale seksuale, ku fokusi është i njëanshëm drejt aspektit spektakolar të lajmeve.

Shumica e raportimit mbi korrupsionin nga ana e mediave shqiptare bazohet në një burim të vetëm, shpesh të paidentifikuar, duke shkelur një nga standardet më themelore të gazetarisë. Sipas Glasser, “burimet furnizojnë kuptimin dhe përmbajtjen e lajmeve të ditës. Burimet ofrojnë argumente, kundërshtime, shpjegime, kritika.”²⁰ Agjencitë serioze të lajmeve ndërkombëtare, si Reuters, kanë protokolle të rrepta për raportimin e ngjarjeve bazuar në një burim, sidomos ato të bazuara në burime të paidentifikuara, të cilat janë konsideruar një përjashtim i jashtëzakonshëm. Në këtë drejtim, media shqiptare bën përpjekje të kufizuara për të vendosur faktet në mënyrë të pavarur ose për të kontrolluar informacionin e dhënë nga politikanët apo zyrtarët publikë ose për të përballur këta zyrtarë me informacionin e pavarur.

Shumica e raportimit për korrupsionin nuk pasqyron pikëpamjet e të gjitha palëve të përfshira dhe në shumicën e rasteve pala e prekur në një çështje apo rast nuk është konsultuar. Kjo gjithashtu tregon një shkëlqje të parimeve të gazetarisë profesionale, e cila gjithmonë duhet të konsiderojë pyetjen e thjeshtë "A u është dhënë mundësia të gjitha palëve të përfshira të prononcohen?"²¹

Treguesi i autorësisë, duke botuar apo transmetuar emrin e plotë të gazetarit, është shumë i ulët. Rreth gjysma e artikujve dhe dy të tretat e kronikave televizive janë anonime. Një shpjegim i mundshëm për normat e ulëta të vendosjes së autorësisë është se disa departamente të lajmeve përpiqen të

20. 'Objectivity Precludes Responsibility', Theodore J. Glasser <http://www.columbia.edu/itc/journalism/j6075/edit/readings/glasser.html>

21. The elements of journalism, <http://www.uiowa.edu/~c019168/168s6online18.html>

fshehin faktin që kanë një staf të kufizuar, gjë që mund të bjerë në sy nëse i njëjti emër do të shfaqet në shumë kronika. Një shpjegim tjetër është se gazetarët kryejnë një vlerësimin të brendshëm në lidhje me rëndësinë e kronikave, duke fshehur emrin e tyre nga kronika që vijnë drejtpërdrejt nga deklaratat për shtyp dhe deklaratat e aktorëve kryesorë ose partive politike.

Të gjitha karakteristikat e mësipërme të identifikuara gjatë periudhës së monitorimit ritheksojnë gjetjet që lidhen me zhanrin e raportimit, gjë që tregon se pjesa më e madhe e artikujve dhe kronikave për rastet dhe çështjet e korrupsionit i përkasin kategorisë së lajmeve. Përqendrimi në këtë zhanër lë pak hapësirë për raporte investigative të thelluara, të cilat duhet të bazohen në një numër të madh burimesh, punë në terren dhe verifikim faktesh, duke u fokusuar në të mirën publike në vend të jetës private, si dhe i kërkon gazetarit të shkojë përtej asaj çka është thënë me qëllim zbulimin e keqbërjes.

5.2 Konkluzione

Të gjitha gjetjet e sipërpërmendura në këtë raport monitorues sugjerojnë që media shqiptare, e shkruar dhe audio-vizive, në një numër të konsiderueshëm rastesh nuk i përmbahet standardeve bazë të gazetarisë në raportimin e rasteve apo çështjeve të korrupsionit.

Saktësia:

Në shumicën e rasteve, media e shkruar dhe audio-vizive ka mangësi në raportimin e saktë të rasteve apo çështjeve të korrupsionit gjatë periudhës së monitorimit. Në mënyrë që raportimi të jetë i saktë, verifikimi i deklaratave është vendimtar. Verifikimi i deklaratave kërkon një numër të madh burimesh. Megjithatë, gjatë periudhës së monitorimit mediat e shkruara dhe audio-vizive

raportuan në mënyrë të rregullt lajme të bazuara në deklaratat politike dhe vetëm në një burim. Në median e shkruar, 67 nga 715 artikuj mbi çështje apo raste të korrupsionit u mungonte plotësisht burimi i informacionit, ndërsa 52% e artikujve kanë vetëm një burim. Në të njëjtën mënyrë, 82% e kronikave televizive mbi çështjet dhe rastet e korrupsionit bazohen në një burim të vetëm.

Objektiviteti:

Për të treguar të vërtetën më të vërtetë të mundshme, mediat duhet të përpiqen të mbledhin deklarata nga palët që janë subjekt i kritikave, akuzave jo të favorshme ose negative. Megjithatë, të dhënat e mbledhura gjatë periudhës së monitorimit nga tre stacionet televizive dhe tre gazetat e përditshme, sugjerojnë që mediat shqiptare kanë nevojë për përmirësim në këtë drejtim. Konsultimi me palët e akuzuara për një çështje të caktuar nuk është kryer në shumicën e artikujve mbi çështje të korrupsionit, me një total prej 505 artikujsh nga 715 ku palës së akuzuar nuk i është dhënë e drejta për t'iu përgjigjur akuzave të shkruara. Mosdhënia e të drejtës së palës së akuzuar për t'iu përgjigjur akuzave apo kritikave është një fenomen i përhapur edhe në kronikat televizive mbi çështje të korrupsionit. Gjatë periudhës së monitorimit, në 212 nga 290 kronika televizive, pala e akuzuar nuk është konsultuar.

Plotësia:

Për të treguar ngjarje që janë më afër të vërtetës, organet e medias duhet të mbështeten në burime të shumëllojshme informacioni, të cilat përfaqësojnë këndvështrimet e ndryshme të shoqërisë në tërësi dhe që kontribuojnë në ngritjen e debatit të informuar. Megjithatë, të dhënat nga monitorimi tregojnë se në mbulimin e çështjeve të korrupsionit, burimet mbi të cilat media shqiptare mbështetet janë zakonisht nga sektori publik dhe partitë politike. Në rastin e artikujve të gazetave, 71% e burimeve vijnë nga sektori publik, ndërsa 25%

nga partitë politike. Në kronikat televizive, partitë politike janë burimet e 56% të tyre, ndërsa sektori publik në 43% të rasteve. Në të dyja llojet e mediave, vetëm 1% e burimeve vijnë nga sektori jo-qeveritar.

Ndershmëria:

Ndershmëria është një parim shumë i rëndësishëm në gazetari, sepse rëndësia e punës së gazetarit varet nga besimi i publikut. Forma më e thjeshtë e ndershmërisë është nënshkrimi i gazetarit në artikullin e botuar apo kronkën e transmetuar. Të dhënat e mbledhura gjatë periudhës së monitorimit tregojnë që një numër i madh i artikujve apo kronikave nuk mund ti atribuohen një gazetari, gjë që i bën të papërgjegjshëm para publikut. Të dhënat e mbledhura përmes këtij studimi tregojnë se vetëm 40% e artikujve të gazetave dhe 32% e kronikave të lajmeve të përmbajë emrin e plotë të gazetarit.

Paanshmëria:

Me qëllim që raportimi të jetë i paanshëm, gazetarët duhet të përpiqen të prodhojnë ngjarje që i tejkalojnë anësitë dhe trajtojnë të gjitha pikpamjet në mënyrë të barabartë. Megjithatë, të dhënat e mbledhura gjatë periudhës së monitorimit tregojnë jo vetëm që gazetarët i bazojnë raportet e tyre në burime që vijnë nga administrata publike apo partitë politike, por edhe që rastet e raportuara bazohen në pseudo-ngjarje, si konferencat apo deklaratat për shtyp të organzuara nga këta aktorë të cilët janë të anshëm si natyrë, dhe palët e tjera të përfshira nuk konsultohen.

Respektimi i standardeve të gazetarisë, si dhe parimeve të etikës profesionale, është i domosdoshëm në mënyrë që media të ketë mundësi të luajë rolin e mbikqyrësit me qëllim që të prodhojë rezultate të drejtpërdrejta në luftën kundër korrupsionit, në përpjekje për t'i dhënë fund kulturës së pandëshkueshmërisë që mbizotëron në Shqipëri.

© Balkan Investigative Reporting Network, Albania
www.birn.eu.com
Tiranë, 2014